

University of Business and Technology in Kosovo

UBT Knowledge Center

Theses and Dissertations

Student Work

Winter 12-2019

GLOBALIZMI NE ASPEKTIN EKONOMIK

Agon Dedushi

Follow this and additional works at: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd>



Part of the [Political Science Commons](#)



Kolegji UBT
Fakulteti i Shkencave Politike

GLOBALIZMI NE ASPEKTIN EKONOMIK

Shkalla Bachelor

Agon Dedushi

Dhjetor/ 2019

Prishtinë



Kolegji UBT
Fakulteti i Shkencave Politike

Punim Diplome
Viti akademik 2014-2017

Agon Dedushi

GLOBALIZMI NE ASPEKTIN EKONOMIK

Mentori: Ardian Uka

Dhjetor / 2019

Ky punim është përpiluar dhe dorëzuar në përmbushjen e kërkesave të
pjeshme për Shkallën Bachelor

ABSTRAKT

Globalizimi është bërë fjala më e përdorur në çdo kohë dhe në çdo kontekst, në diskutet ndërkombëtare zyrtare dhe jozyrtare në kontekstin e ndërvarësisë së ekonomisë dhe kombeve. Globalizimi ka evoluar me kalimin e kohës. Globalizimi ka filluar të jetë i rëndësishëm që prej përfundimit të luftës së ftohtë dhe ka përshpejtuar çlirimin e shpejtë të ekonomive në zhvillim. Globalizimi nuk është një fenomen thjesht bashkëkohor. Sipas Chanda: "*i punuar në heshtje për mijëra vite pa iu dhënë një emër*". Vërtet, proceset e globalizimit po evoluojnë vazhdimisht, të shtyrë nga aspiratat ekonomike të miliona rreth globit sa më shumë njerëz të përfshirë aq më shpejt ndodh globalizimi.

Qëllimi i këtij studimi është që të analizohen efektet e globalizimit të përcaktuara në integrimin e aktiviteteve ekonomike, kryesisht përmes tregjeve, në qëndrueshmërinë ekonomike dhe globale, karshi konkurrencës në sektorin e Bashkimit Evropian. Globalizimi ka hapur mundësi të reja për një zhvillim të gjerë në mbarë botën. Megjithatë, kjo nuk është duke u zhvilluar në mënyrë të barabartë, sepse disa qarqe janë duke u integruar në ekonominë globale më shpejt se të tjerët me dëshmi të rritjes së shpejtë dhe varfërisë së reduktuar. Për konsekuencë, një koncept kuadri koherent analitik është përdorur përgjatë studimit. Studimi përbëhet nga një rishikim i literaturës dhe një vlerësim nga faktorët kryesorë të globalizimit.

Fjalë kyçe: Globalizimi, tregjet ndërkombëtare, konkurrenca e tregjeve të Bashkimit Evropian, zhvillimi global i ekonomive të vendeve në zhvillim

MIRËNJOHJE DHE FALENDERIME

U jam mirënjohës të gjithëve, që në çfarëdo mënyre kontribuan në kryerjen dhe përfundimin e këtij punimi e sidomos: Profesor **Ardian Uka** që më ndihmoi për përfundimin e Temës Diplomes.

Falenderim edhe për Profesorët, asistentët, stafin udhëheqës dhe gjithë personelit e Kolegjit UBT të cilët gjithmonë dhe në çdo kohë kanë qenë të gatshëm për të më ofruar këshilla dhe motive studimi me përkrahjen e tyre të pakursyer shkencore morale e profesionale.

Në fund, por jo edhe në vendin e fundit, falenderoj familjen time, dhe i shpreh mirënjohje të thellë, të cilës i detyrohem shumë për fillimin dhe finalizimin me sukses të këtij udhëtimi, sa të vështirë, aq edhe të bukur, për mirëkuptimin, durimin, mbështetjen dhe përkrahjen që më kanë ofruar, për çka për jetë u jamë mirënjohëse dhe falenderuese.

PËRMBAJTJA

FJALORI I TERMAVE	IV
1. HYRJE	1
2.SHQYRTIMI I LITERATURËS	3
2.1 GLOBALIZIMI DHE EKONOMIA	4
2.1.1 Fenomeni Globalizem	4
2.1.2 Refleksionet e Globalizimit në ekonomin globale	6
2.1.3 Zhvillimi i avansuar teknologjik dhe ekonomia globale.....	7
2.1.4 Ndikimi i Fondit Monetar Ndërkombëtar ne ekonominë globale	8
2.2 Ndikimi i supërfaqëve në ekonomin globale	11
2.2.1 Ndikimi i unionit europian	11
2.2.2 Shtetet e Bashkuara të Amerikës në ekonomin gloale	13
2.2.3 Ndikimi i Kinës në ekonomin Globale.....	14
2.2.4 Ndikimi i Japonisë në ekonomin globale	17
2.2.5 Ndikimi i Ruisë në ekonomin Globale	18
2.3 GLOBALIZMI DHE VENDET NË TRANZICION	22
2.3.1 Integrimi i vendeve në tranzicion në ekonominë globale	22
2.2.2Ekonomia e brishtë e Kosovës dhe globalizimi	24
3.DEKLARIMI I PROBLEMIT	26
4.METODOLOGJIA	27
5.PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME	28
6.REFERENCAT	31

FJALORI I TERMAVE

UE- Unioni Evropian

OKB- Organizata e Kombëve të Bashkuara

FMN- Fondi Monetar Ndërkombëtarë

GATT- Marrveshja e përgjithshme mbi tregtine e lirë dhe doganat

ESCS- Eurocean coal and steel Community-Bashkësia Evropine për Thengjill dhe Qelik

ESCB-Rregullon e mbikqyrë funksionimin e bankave qendrore të seteve anëtare

ECB- Banka qendrore e Evropës, mbikqyrë sistemin monetar të përbashket

EMI- Instituti monetar i Evropës , hulumton mundësit e funksionimit dhe të pengesave

CEN- Komiteti i Evropës për standartizin

BPSH- Brutoprodukti shoqëror

NAFTA- Marrveshje e tregëtisë së lirë të amerikës së veriut

AOL- America Online

TNC – Korporatat Transnacionale

1. HYRJE

Në këtë punim diplome do të bëj përpjekjen që të trajtojë një temë mjaftë komplekse që ka të bëjë me procesin e globalizimit dhe ndikimin e tij në ekonomin globale. Globalizimi ekonomik bashkëkohor e ka zanafillën e vet në lindjen graduale të një rendi të ri ekonomik ndërkombëtar , rrënjët e të cilit nisin në një konferencë ekonomike të mbajtur nga fundi i luftës së dytë botrore, në qytetin ndoshta pak të njohur Breton Woods, nën drejtimin e SHBA-ve , Britanisë së Madhe.

Një ndikim të veçantë në ekonomin globale ka globalizimi, që kuptohet si lidhje apo bashkëpunim në mes të të gjitha vendeve të botës në të gjitha aspektet. Gjithashtu ndikimi i tij mund të vërehet çdo ditë në do shoqëri. Një ndikim të veçantë në ekonominë globale ka zhvillimi teknologjik që ku si ndihmues direkt i globalizimit. Të marim vetëm shëmbull interneti dhe ndikimin e tij që ku në mbarë globin në lidhje brilante socio-ekonomike, ku nga një vend mund të kryhen tregti të ndryshme në gjithë botën.

Një ndikim shumë të madh në procesin globalizimit kanë kompanitë transnacionale (TNC). Këto kompani kanë shtrirje në shumë vende të botës, dhe me prodhimet e tyre kanë prani në mbarë botën, dhe ndikimi i tyre realizohet në dy mënyra: duke u shkrirë në njëra tjetrën, apo duke privatizuar kompanitë nacionale në vendet me të varfëra, në këtë menyrë këto kompani po zotërojnë ekonominë globale. Këto kompani kanë prejardhje nga vende të ndryshme konkretisht nga superfuqitë globale si p.sh: SHBA, UE, KINA, JAPONIA, RUSIA. SHBA është superfuqi me faktin se dominon në katër sfera: ekonomike, politike, kulturore dhe ushtarake.

UE-ja me një treg shumë të madh dhe më të integruar është një nga superfuqitë globale sepse posedon shumë Korporatat transnacionale (TNC) të fuqishme gjë që e ka rritur Brutoproductin Shoqëror (BPSH) të UE-së. Kina ka një rritje të shpejt ekonomike, produktet kineze po mbulojnë gjithë tregun global, ku fuqia kryesore e tyre është eksporti , kështuqë Kina po bëhet konkurrente shumë e denjë e superfuqive globale për dominim ekonomik. Ndërsa Japonia me zhvillimin teknologjik është bërë pothuajse e paarritshme sepse kompanitë Japoneze në vendet ku veprojnë e qojnë në deficit çdo kompani konkurruese shëmbull i kësaj është SHBA-ja, ku kompanitë Japoneze kanë bërë një “bum” të madh që po i frigonë të gjitha fuqitë ekonomike. Rusia ka një ndikim më të veçantë se vendet që përmendem me lartë. Sepse të gjithë kapitalin

e saj dhe gjithë prodhimtarin e ka fokusuar vetëm në energjetikë, në gas naftë dhe thëngjill. Duke pas parasyshë çmimin e madh të naftës fitimet e Ruisë janë shumë të mëdha, dhe ndikimin e Ruisë e karakterizon varësia e vendeve të UE-së për gas dhe naftë.

Një ndikim të madh globalizmi ka në vendet në tranzicion. Dhe këtë ndikim e arrin në dy forma: përmes Korporatave të Mëdha Ndërnacionale (TNC), dhe institucioneve financiare si Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore . FMN-ja me politikat e saja imponuese , u imponon vendeve në tranzicion apo vendeve të varfëra parimet e saj, ku tri më kryesorët janë kontrollimi i buxhetit , liberalizimi i tregut dhe privatizimi.

2.SHQYRTIMI I LITERATURËS

Ky kapitull është ndarë në disa pjesë që ndihmojnë për të krijuar kuadrin teorik të të gjithë punimit në mënyrë të qartë. Kemi shqyrtuar një numër të konsiderueshëm të literaturës e cila na ka ndihmuar të kuptojmë që globalizmi nuk është një fenomen thjeshtë bashkëkohor, shumë studiues tani e njohin globalizmin në kuptimin ekonomik, social dhe kulturor me shoqërinë e vet globale. Gjithëashtu kemi përfshirë një sërë definimesh, kuptimesh, analiza, shkrime të ndryshme të zhvilluara dhe të trajtuara në këtë punim.

2.1 GLOBALIZIMI DHE EKONOMIA

2.1.1 Fenomeni Globalizem

Kur flasim për globalizmin menjëherë duhet të cekim se nuk ekziston një definicion striktë për globalizimin, kjo lenë të kuptohet se për globalizmin ka definicione të shumta, pra se të fillojmë të flasim për globalizimin do të japim disa definicione nga autorë të ndryshëm , që janë marrë në librin e Manfred Steger ‘‘Globalizimi’’.Një definicion i dhënë nga David Held (profesor i shkencave politike në shkollën ekonomike të Londres), e përkufizon globalizmin si nje proces apo një sërë procesesh që mishëron një transformim në marrëdhëniet dhe transaksionet sociale të vlerësuara në terma të shtrirjes, intensitetit, shpejtësisë dhe ndikimit të tyre, duke krijuar rrjedha ndëkontinentale dhe ndër-rajonale, si dhe rrjete veprimtarie ndërvepimuese dhe ushtrim të pushtetit. Ronald Robertson (profesor i sociologjisë ne Univerzitetin e Pitsburgut) e definon globalizmin si koncept që i referohet ngushtimit të kufinëve në mbarë botën.

James Mitelman (profesorë i marrëdhanieve ndërkombëtare në Universitetin Amerikan të Neë York), e definon globalizimin si aspekt kohor dhe hapësinorë të Universitetit Amerikan ne Neë York të marrëdhënieve sociale. Anthony Giddens (2017) qe thotë: ‘‘Termi i përgjithshëm që shpreh ndërvarësinë në rritje të shoqërisë botërore është globalizimi’’ (fq. 495). Duke u bazuar në aktualitet, globalizimi mund të vërehet për cdo ditë , p.sh nëse hym në një supermarket do të gjejmë produkte nga më shumë se 100vende, të cilat gjinden pothuajse në cdo treg të vendeve në gjithë globin. Apo vetëm nëse analizojmë makinat në rrugë , kompjuterët, e shumë paisje tjera teknologjike, na bëjnë të mendojmë se globalizimi gjendet në cdo cep të botës. Bile globalizimi mund të vërehet edhe tek ata të cilët e kundërshtojnë globalizmin p.sh në vendet e lindjes së afërt kemi produkte nga me të ndryshmet, produkte ushqimore si Mc Donalds etj. Globalizimi vërehet edhe tek atë të cilët e kundërshtojnë plotësishtë atë, e në anën tjetër e shfrytzojmë globalizimin për të arritur sukses në qëllimet e tyre. Globalizmi me karakteristikat e tij po ndikon edhe në zonat rurale sepse me ardhjen e teknologjisë se re, bashkë më këtë edhe depërtimin e kulturave të reja të cilat po mbizotërojnë mbi kultuën trandicionale, ndërsa po binë ndesh me kultura trandicionale në zona rurale ku akoma ruhet një pjesë e vlerave kulturore trandicinale. Në këtë kontekst vlen të ceket se kush e përkrah globalizimin dhe kush

e kundërshton. Të gjithë ata që kanë dobi nga globalizimi e përkrahin globalizimin kurse ata që e kundërshtojnë janë disa kategori.

Globalizimi e kundërshtojnë të gjithë ata që humbin vendet e punës, pra ata të cilët mund të përshtaten me perparësitë që sjellë globalizimi p.sh. zhvillimi teknologjik, procesorët me kalkulime fleksibile e heqin nevojën për punën manuale. Grup tjetër kundërshtues janë edhe ato grupe të cilat akuzojnë globalizimin se po sjellë kultura të reja (të kqija), e që po ndryshojnë atë shoqëri në aspektin kulturor. Në këtë kontekst “mund të themi tërthorazi se procesi i globalizimit do të mund të këndvështrohej nga dy perspektiva. Në njerëzimi një ditë do të bëhet pjesë e një mënyrë të vetme të menduari, një shoqëri e vetme, e ndoshta edhe një qeveri e vetme? Në anën tjetër, është e natyrshme të mendohet se një projektim i tillë i ngjarjeve të sipërme nuk është as realis as ndoshta i nevojshëm ngase dallimet mes indentiteteve të ndryshme kulturore etike dhe atyre racore gjithnjë ekzistojnë (Maloku, 2003, f.71). Kur jemi të definimi i globalizimit duhet të cekim edhe anët negative të globalizimit, si bartja me efektet e virusit të AIDS-it, zhvillimi më i madh i kontrabandave, sepse me hapjen e kufijëve ky aktivitet lehtësohet. Në anën tjetër kemi anët positive të globalizimit, zhvillimi teknologjik, internet po mundëson një asimilim shumë më të ngadalshëm, telefonat mobil, laptopet, etj. Këtu lindin debate se a është globalizimi i mirë apo i keq, e që sjellë në dilemë shumë studiues të këti fenomeni. Mirëpo kemi edhe qëndrime neutrale siç është rasti i Papa Gjon Palit të dytë. Ku në akademinë papnore të shkencave shoqërore ai thotë: *globalizimi duhet si çdo proves tjetër të jetë në shërbim të njerëzimit, pra ai nuk e definojnë globalizimin as të mirë as të keq, por varet se si udheheqet me të.*

“Ish presidenti i SHBA-ve Bill Clinton, para audiencave të ndryshme, si Universiteti Kombëtar Vietnamez dhe forumi ekonomik botërorë, pa përmendur tubime tjera të panumërta deklaroi se : Globalizimi nuk është diçka që mund ta zbrapsim ose ta shuajmë. Ai është një ekuivalent ekonomik i forcës së natyrës siq është era, uji... ne nuk mund ta injorojmë atë dhe ai nuk do të largohet”.(Berzezinski, 2006, f.115).

Nga të gjitha këto karakteristika të cekura me lartë mund të themi se edhe përkundër kundërshtimeve të shumta që krijojnë të ashtuquajturat elemente antiglobaliste, një gjë është e qartë globalizimi është një proces që nuk mund ta ndalë askush.

2.1.2 Refleksionet e Globalizimit në ekonomin globale

Në ditët e sotme globalizimi ka një rëndësi shumë të madhe në ekonominë e të gjitha vendeve përkatësisht në ekonominë globale. Globalizimi mundëson këmbim ndërkombëtar edhe në vendet postsocialiste, që para një kohë jo të largët ka qenë përbrenda ish federative të tyre. Tani të gjitha shtetet në tranzicion të Evropës me shumë së 50% të kombinimi tregtar të importit dhe eksportit e bëjnë në vendet e Unionit European.(Selmani, 2006, f. 17) Mirepo profelizimi i pozitës ndërkombëtare të shteteve të reja europiane në këmbim ndërkombëtar varet drejtpërdrejt nga garnituara qeverisese dhe aftësia e tyre për ta drejtuar zhvillimin e shoqërive të shteteve të tyre, duke përqendruar ristrukturimin funksionalë dhe zhvillimin adekuat të ndërmarrjeve të cilat do të duhen të bëhen funksionale në tregti dhe ashtu të organizuara të arrijnë të integrohen në këmbimin ndërkombëtar, konkretisht në ekonomin globale. Karakteristikë e globalizimit është se mundëson tregti të hapur, siç dihet tregtia e hapur i mundëson çdo vendi që të zgjerojë prodhimin e vet, duke ngritur në këtë mënyrë standartin jetësor të qytetarëve në nivel botëror. Ndikimin e globalizimit në ekonominë globale e ndihmojnë edhe institucionet të cilat bëjnë përpjekje për ti hequr Doganat dhe që të ketë një liberalizim të tregut. Një nga këto instiucione është Marrëveshja e Përgjithshme mbi Doganat dhe Tregti (GATT). Gati u mundëson rrethë vendëve anëtare dhe paraqet afërsishtë 85% të tregtisë ndërkombëtare. Parimet themelore mbi të cilat mbështetet gati janë:

1. Vendët duhet të punojnë në drejtim që të ulin ndalesat tregtare.
2. Të gjitha ndalesat tregtare do të duhej të janë të aplikueshme mbi bazat jo diskriminuese, të gjitha vendet do të duhej të perjetojnë statusin e kombit të privilegjuaar.
3. Kur vendi ngrit Doganat mbi nivelin e marrëveshjes paraprake duhet të kompensio partnerin e vet në tregun e jashtëm , dënim ekonomik që i ka sjellë.
4. Konfliktet tregtare do të duhej të zgjidhen me konsultime. (Selmani, 2006, f. 21)

Në kuptimin e plotë të fjalës mund të themi se ekonomia globale është bërë fizikisht e materializuar në portet detare, airoporet, në stukturat telekomunikuese etj. Gjthashtu ekonomia globale po krijon themelet ndërmjet institucioneve politike, nacionale që i kontrollojnë veprimtarit ekonomike dhe forcat ekonomike ndërkombëtare të cilat duhet të kontrollojnë atë. Pra, në vende që politikat të qeverisë me forcen ekonomike, ekonomia

globale po e krijon botën në të cilën forcat gjeo ekonomike internacionale po i diktojnë politikat nacionale ekonomike. Me internacionalizim qeveritë po humbin shumë nga instrumentet tradicionale të kontrollit të tyre ekonomik. Globalizimi ekonomik i referohet intesifikimit dhe zgjerimit të ndërvarsisë ekonomike në mbarë rruzullin tokësor. Keshtu që tregjet janë shtrirë në mbarë botën, diku krijuar kështu lidhje të reja në mes ekonomive kombëtare. Korporatat shumë të mëdha ndërnacionale (TNC), dhe institucione të fuqishme ekonomike ndërkombëtare dhe sisteme të mëdha tregtare rajonale kanë lidhur si blloqe të mëdha ndertimi të rendit ekonomik global të shekullit 21.(Steger, 2003, f.55)

Gjatë viteve të fundit debati politik për përfitimet dhe të metat e tregtisë së lirë arritin në një pikë kritike, kur vendet e pasura i shtuan përpjekjet e tyre për të krijuar një treg të vetëm global. Globalizimi shtoi ndikimin e nëpërmjet marrëveshjeve rajonale dhe globale të liberalizimit të tregtisë siq janë NAFTA dhe GATT-i, kështu që eliminimi i pengesave për tregti mundëson që të kemi një shpërndarje të teknologjisë në gjithë botën dhe një formë duke depërtuar në ekonomitë e të gjitha vendëve.

2.1.3 Zhvillimi i avansuar teknologjik dhe ekonomia globale

Globalizimi krijon lidhje afariste jashtë kufinjëve shtetëror përhapë inovacionet dhe zhvillon tipe të reja të mardhënjeve shoqëore në largësi të mëdha. Duke iu falenderuar teknologjisë së re informative, transportit dhe komunikimit të lirë ë gjitha këto lidhje janë të mundshme dhe lehtë të arritura.” (Selmani, 2006, f. 161)

Përhapja e informative të llojlojshme ka ndikuar që bota të duket e vogël dhe e arritshme. Një nga zhvillimet teknologjike që ka bërë lidhjet me të medha ne gjithë vendet e globin tonë është interneti mund të themi se ka bërë më të lehtë zhvillimin e komunikimit në të gjitha aspektet e jetës. Ky përparim i madhë teknologjikë vënë në ri dekadat e fundit dhe është një tregues i mirë për ndryshimet socio-ekonomike që po ndodhin. .(Steger, 2003, f.63)

Interneti në fillim është përdorur vetëm në fushën ushtarake por më vonë kokretishtë ne vitin 1992 është vënë edhe në shërbimi të njerëzimit. Sipas analizave të reja shkencore dhe teknologjike, të cilat e kanë karakterizuar shekullin 20-të, interneti është në majë të tyre ndërsa ne vitin 1992 konsiderohet si vitë i kthesës perkashisht internet eshte berë një e mirë e përgjithshme ë gjithë njerzimit. Hulumtimet dhe analistët e ndryshëm po tregojnë se interneti

po e nxitë njaftë inkuadrimin e bashkësisë në aksione dhe mardhënje në largësi. Teknologjia informatike në këtë rast po e përmirëson komunikimin lokal dhe ndërkombëtar. Gjithashtu po e lehtëson komunikimin në largësi dhe kështu po i forcon lidhjen në mes të njerzëve në të gjitha aspektet. Disa analistë këtë dukuri të përmirësimit të komunikimit global dhe lokal, e cila po e rezulton në forcimin e përbashkët po e emërojnë si glocalizacion. Duke iu falenderuar teknologjisë informative njerëzit gjithnjë e më shumë po komunikojnë nga largësia. Ata do të dinë për ngjarjet në tërë globin dhe mund të marrin pjesë përmes aksioneve dhe shoqërive civile siq janë organizatat jo qeveritare.

Një rëndësi të veçantë në fushën e teknologjisë në kontekst të zhvillimit ekonomik global kanë edhe paisjet e tjera elektronike digjitale si përdorimi i telefonave celularë iu mundëson njerëzve më mbarë botën që të kenë një qasje në cep të globit me një shpëjtësi shumë të madhe. Një rëndësi në ekonominë lokale dhe globale në aspektin e shit-blerjes kanë dhe kartelat mençuara. Këto kartela si paisje të sofistikuara u mundësojnë njerëzve që të realizojnë shit-blerjen në vende të ndryshme duke mos pasur nevojë për shuma të mëdha parash me vete. Baza e teknologjisë së globalizimit është zhvillimi i teknologjisë komunikuese dhe informative. Mallra, shërbimet dhe posaqërishtë informatat po levizin në rruzullin tokësorë në mënyrë të atillë që ka qenë e pa mundur të mendohet. Kur jemi të ndikimi i teknologjisë informative vlenë të theksohet se në raportine dhënë për zhvillimin human të Kombeve të bashkuara thuhet: Në tregun botërorë valutorë tani këmbehen me shumë se 1.5 trilion dollar, për çdo ditë kurse tregohen gati 1/5 e prodhimtarisë vjetore të mallrava dhe të shërbimeve. (Panian, 2004 f.234)

Pra zhvillimi i avansuar teknologjik ka një rëndësi shumë të madhe në zhvillimin e ekonomisë globale, ku përmes kësaj teknologjie realizohen me miliarda aktivitete biznesore në mënyrë të saktë dhe të shpejtë.

2.1.4 Ndikimi i Fondit Monetar Ndërkombëtar ne ekonominë globale

Globalizimi një ndikim të madh e arrin përmes institucioneve gjigande financiare siç është Fondi Ndërkombëtar (FMN). FMN-ja lindi nga sistemi I Breton Woods-it veqanarishë pas rënjes së Bashkimit Sovjetik, program ekonomik i FMN-së ka sinkronizuar rregulla neoliberale, për tu integruar dhe çlirua nga kontrolli tregjet në mbarë botën kështu që Detyra

më e vështirë për krimin e stabilitetit global ekonomik ju dha FMN-së ata që u mbledhen në Breton Woods e patën të fresket në mendjen e tyre krizen globale ku kapitalizimi u ballafaqua me krizen e tij më të rëndë deri më tani. FMN-ja është menduar si bankë qendrore e të gjitha bankave tjera në qëllim që tu ndimoi atyre vendeve më nevojë, kurset valutore të cilave janë bërë jo stabile për shkak të vështirësive në bilancin e pagesave. (Polovina, 2006, 5412.) Mund të themi së globalizimi përmes FMN-së u përcakton vendeve borxhlinjë, apo vendeve të cilat duan të marrin kredi nga FMN-ja. Politikat e saj imponuese. Në këtë kontekst vlenë të theksohet se në vitin 1990 krijohet një pakt politikash neoliberalë që shpesh njihen edhe si Konsensusi i Ëashingtonit.. që u kryjua dhe u perjektua nga John Ëillamson, që ishte këshilltar i FMN-së në vitet e 70-ta. Kështu që FMN vendeve që duan të marrin kredi u imponon dhjetë pikat e konsensusit të Ëashingtonit e që shikuar në aspektin kritiki është një formë e re e kolonizimit.

Këto dhjetë pika janë

- I. Një garanci e disciplines fiskale dhe një ulje e deficitit buxhetor
- II. Një pakësim i shpenzimeve publike, veqanarishë një ushtri e në administratat publike
- III. Reformë taksash që do të synonin krijimin e një sistemi me bazë të gjerë dhe me një zbatim të detyrueshem fiskal
- IV. Liberalizim financiar me përqindje interesi të përcaktuar nga tregu
- V. Përqindje shkëmbimi për të ndihmua rritjen e shkaktuar nga eksporti
- VI. Liberalizim i tregtisë i lidhur me heqjen e liqencave të importit
- VII. Nxitjen e investimveve të huja të drejtpërdrejta
- VIII. Privatizimin e ndërmarrjeve shtetrove, që bije në një menaxhim të mirë dhe një performancë të përmirësuar
- IX. Çlirimi i ekonomisë të pronësisë
- X. Mbrojtja e të drejtave të pronësisë.

Mund të themi së ndikim të veqante FMN-ja arrin përmes tri shtyllave kryesore:

Kontrollimin e buxhetit

Liberalizimin e tregut

Privatizimin

Përmes kontrollimit të buxhetit FMN-ja u imponon qeverive të vendeve të cilat kanë marrë kredi nga ky institucion, që të bëjnë kufizimin në sektore të caktuara, dhe këtë pa i marrë parasysh rrethanat e atij vendin, e kemi rastin e Tailandës ku ata e shohin SIDA-n që po shtohet si rezultat i shkurtimeve të detyruara në shpenzime për shëndetësi nga ana e FMN-së . Ky është shembulli më tipik i pasojave që sjellin politikat imponuese të FMN-së. Liberalizimi i shpejtë i tregut që është kusht i FMN-së ka ndikime negative për ekonomitë e varfura. Liberalizimi i tregut nënkupton marrjen e produkteve nga jashtë e që paguajnë shumë pak dogana. Apo kemi rastin kur FMN-ja kishte insistuar në liberalizimin e financiarë të tregut, duke besuar se konkurrenca në mes të bankave do të qonte në një përqindje më të ulët interesin.

Rezultatet kanë qenë katastrofale: lëvizja çoi në një rritje shumë të shpejtë të bankave lokale dhe komerciale, në një kohë më të cilën legjislacioni bankar dhe mbikqyrja bankare ka qenë joadekuat me rezultatet e parashikuara 14 dështime të bankave në keto vitet 1993-1994, në fund përqindja e interesit u rrit e nuk u zvogëlua. Edhe privatizimi i shpejt cilësohet dëmshëm për ekonomitë e vendeve të varfëra, sepse më ardhjen e TNC-vë kompanitë nacionale falimentojnë. Kështu që të gjithë timonin e kanë në dorë TNC-të dhe në rast të ngritjes së qmiveve këto TNC ai vend veq sa do të varfërohët. Në bregun e Fildishtë një kompani telefonike u privatizua ashtu si ndodhë shpesh para se të krijohet një rregullues adekuate ose një model për konkurrencë (Dolaku, 2011). Një firmë franceze e cila kishte blerë pasurinë e vendit e bindi qeverinë për t'ia dhënë asaj monopolin, jo vetëm për shërbimin ekzisues të telefonisë , por edhe për shërbimin e ri celularë. Firma private ngrit aq shumë çiminin, sa që p.sh studentët e Universitetit nuk kishin mundësi që të kyqeshin në internet. Pra shikuar nga aspekti kritik FMN-ja përmes këtyre tri shyllave e që janë bazike për FMN-në vetëm sa i d vendet në varfëri në të shumtën e rasteve. Këto raste duhet ta frikesojne qeverinë e Kosovës se a duhet të kërkojnë ndihmë nga FMN-ja.

2.2 Ndikimi i supërfuqive në ekonomin globale

2.2.1 Ndikimi i unionit evropian

Unioni Evropian (UE) ka një ndikim të madh në ekonominë dhe në tregun global. Evulucioni i idesë së Europës së bashkuar, rrethanat e favorshme të zhvillimit bashkëhor të saj i ka gjetur pas Luftës së Dytë Botërore. Bashkimi politikë dhe ekonomik ka qenë qëllim i shumë sunduesve që janë përpjekur ta ndërtojnë dhe permbajnë perandorinë kontinentale Europiane. Qështja e Europës së bashkuar ka qenë gjatë historisë e theksuar shumë herë dhe u udhëhequr nga motivet politike, edhe pse motiv ekonomik social-kulturore ka qenë gjithashtu në mesin e prioriteteve. Iniciativa për Bashkimin Evropian ka rrjedhur pas krijimit të organizatave të para ndërkombëtare dhe insitucionale në shkallë globale. Pra themelet e atëhershme të BE-së janë krijuar menjëherë pasi janë kryer projektet globale të organizatave globale siq janë: Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB). Në këtë kohë janë krijuar edhe institucionet e tjera si Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtarë (FMN), si dhe në të njëjtën kohë është nënshkruar marrveshja e përgjithshme mbi doganat dhe tregtinë e lirë (GATT).

Këto institucione janë krijuar me qëllim të ruajtjes së paqes mbrojtjes së të drejtave njerëzore, respektimin e të drejtave të qytetarëve rregullimit të rendit global dhe të perparimit të tregtisë botërore. Edhe pse BE-ja me zhvillimin e vet të më vonohshëm është integruar për të arritur qëllimet ekonomike, ideja fillestare që ka sjellë deri të themelimi i bashkësisë së parë në përbërje të saj (Bashkësia Europiane për Thëngjill dhe Qelik-ESCE), ka qenë në të vërtetë e natyrës politike. Gjithashtu kemi edhe krijimin e institucioneve tjera të cilat janë krijuar që në ndihmohet dhe të kordinohet funksionimi i fondit monetarë. Fjala është për sistemin e Europës të Bankave Qënsorev(ESCB), Bankës të Europës (ECB) dhe mbi Institucionin Ndërkombëtarë të Evropës (EMI). Pra të gjitha këto institucione i mundësojnë UE-së që të jetë një treg i integruar. UE në vitin 1985 ka miratuar rezolutë mbi pozicionimin e ri të barazimit të rregullave teknike dhe standarteve me të cilat janë definuar bazat e politikës së ardhme të standartizimit meqe konferenca e re mbi Breton Woods-in nuk mund të mbahet pa një fuçi dominante që do të impononte të tjerëve që të pranojnë bisedimet e Europës, në Bruksel do të behen defaktor konferenca e re e Breton Woods-it. Pra UE-ja është e fuqishme sepse ka një proces të fortë integrimi të vendeve e të cilat kanë një Burutoprodukt Shoqëror të Madhë, e që e bënë një nga guqitë më të mëdha në tregun global. është sfidë e vjetër historike se rregullat tregtare i shkruajnë ata që e kontrollojnë pjesën më të madhe të tregut në botë. Pra hyrja në këtë treg është e

rendësishme për të gjithë të tjerët, dhe shteteve me të vogla nuk ju mbetet tjetër pos që të luajnë sipas rregullave, gjithëherë ka qenë kështu. Kurse në luftën për dominim global në aspektin ekonomik UE-ja pritet që ti shkruajë rregullat e lojës në shekullin XXI, dhe këtë për arsye së proceset integrative të UE-së po shkojnë drejtë një fuqizimi të madhe.

Shikuar nga një prizem tjetër UE-ja ka arritur sukses apo edhe do të arrijë duke pasur pasasysht friken nga fuqite e tjera ekonomike globale, që nëse i shtrijnë veprimtaritë e tyre ekonomike UE-së do ti sillnin problem serioze. Po marrim shëmbull Japonin dhe ndikimin e saj në tregun amerikanë e që ndikim ja futë friken UE-së.

Nuk është i nevojshem asnjë gjeni automobilave europiane që të vërehet se ne terrenin neutral ne tregun amerikan Japonezët e kanë arritur atë që në boks quhet “nokaut teknik”. Padyshim e gjithë prodhuesit europiane ose janë larguar nga tregu Amerikan ose janë duke e humbur shpejtë një pjesë të këtij tregu.

Dhe frika qëndron në faktin se Japonezët atë që bënë në Amerikë do ta bëjnë edhe në Europë, në qoftë se do tu jepet mundësia. Në ato tregje të cilat kanë qenë të hapura, Japonezët në vitin 1990 e kanë mbuluar me rreth 30% tregun e automobilave në tregun Global. Në disa tregje siç janë Irlanda dhe Norvegjia pjesa Japoneze ka qenë me më shumë se 40%. Por Japonezët këtë e arrinin edhe me punën e perpiktë e të shpejtë të tyre, “*Ata mund ta kompletojnë një automobile vetëm me një të katërten e fuqisë punëtore që është e nevojshme për në Evropë*”. Shumë shpejtë venë modelet e reja në prodhim kurse automobilat e tyre posedojnë më pak gabime. Nuk është aspak e rastit kur kryetari i “Fiatit” Italianë kërkon masa me qëllim që të mbahen nën kontroll Japonezët. Duke i parë këto rreziqë UE-ja përdorë disa strategji për tu mbrojtur nga depertimi i fuqive më të mëdha ekonomike, p.sh po të shikohen mundësitë e hyrjes së bankave të huja në tregun e UE-së, apo zgjerimin e tyre në këtë treg atherë hyn në funksion doktrina e reciprocitetit. Europa mund të ndaloj hyrjen e bankave Amerikane në Europë apo zgjerimin atyre të cilat janë prezente, me arsyetimin së në shumë shtete Amerikane nuk lejojnë banka ndërshtetore. Në çoftë së ndonjë banke Europiane nuk ka prani në tërë Amerikën, atherë as bankat amerikane nuk mund të kenë prani në tërë Europën.

Pra në këtë aspekt si Amerika ashtu edhe UE-ja veprojnë me reciprocitet. UE-ja është bërë integrim me i fuqishëm tregtarë në ekonomin botërore ku BPSH e UE-së ka arritur në 10 bilion dollarë, kurse ai i SHBA-vë 7 bilion ai i Japonesë me afer 3 bilion dollar, Prandaj UE-ja është

tregu më i fuqishëm dhe me strukturë të funksionimit më të mirë të rregullave tregtare të shkruara. Mirpo UE-ja po përballet me problem të ndryshme, pas vitit 2003 dhe të një viti të funksionimit të valutës së përbashket unioni po ballafaqohet me problem rreth harmonizimit të rregullave për funksionimin e sistemit monetar. Lufta kryesore është dukë u bërë në drejtim të rrespektimit të rregullave më të cilat patjetër duhet të sigurohet stabiliteti i monedhës së përbashkët EURO. Qellimi themelorë është që të gjitha vendët ti rrespektojnë rregullat monetare në mënyrë strikte. Qysh para tri vjetësh është krijuar rregulla që ka të bëjë me ato se bugjeti nacional i shteteve nuk guxon të jetë në deficit më të madhë se 3% nga BPSH-ja.

Pikërisht kjo rregull e bënë edhe më të fortë UE-në qe vendet anëtare të mos kenë këtë dëficit, njeheri kjo siguron drejtë sigurimit më të madh të BPSH-së që është një nga karakteristikat e UE-së. Për fund mund të themi edhe përkunder disa problemeve që i ka UE-ja e që i cekëm më lartë si psh. Harmonizimi i rregullave për të funksionuar si një tërësi e integruar, UE-ja është bëtë katalizatorë i ndryshimeve që po ndodhin në ekonomin globale.

2.2.2 Shtetet e Bashkuara të Amerikës në ekonomin gloale

SHBA-të pas Luftës së dytë Botërore kanë dallur shumë të fuqishme ekonomikishtë sa që asnjë vendë nuk ka mundur të krahasohet me të, dhe pikërisht nga ajo kohe SHBA-të kan krijuar një bazë të fortë ekonomike. Tregu Amerikanë në vitin 1950 ka qenë nëntë herë më i madhë sesa tregu Anglez, dhe i dyti për nga madhësia në botë. Për këtë arsye ekonomia Amerikane ka përjetuar përparësitë e ekonomisë dhe ka arritur në nivel me kombet e tjera dhe që këto të fundit as që kanë mundur ta ëndërrojnë. Prodhimtaria masive Amerikane ka qenë praktikisht monopol Amerikan, kurse qmimet për njësi të prodhimit në degët siq janë ajo Automobilistike dhe ajo e qelikut kanë qenë të pa arritshme edhe për prodhues më të mëdhenjë të huaj.

Pikërisht në këtë periudhë kohore SHBA-te kanë qenë dominuese në ekonominë globale, P.SH. Në vitin 1950 BPSH e këtij shteti ka qenë më e lartë se në Kanada, tri herë më e lartë se në Angli, katër herë më i lartë se në Gjermanin Perëndimore dhe pesëdhjetë herë më i lartë se në Japoni. Këto karakteristika i kanë mundësuar SHBA-ve që të gjitha produktet masive që i kanë prodhuar, të jenë të pranishme në gjithë globin kështu duke ndikuar në tregjet globale. Mirpo tani për tani SHBA-të nuk e kan atë superfuçi dominuese, këtë për arsye të fuçizimit të UE-së, ku BPPSH-ja e UE-ja e ka kaluar atë të SHBA-ve, gjithashtu edhe kompanitë Japoneze po i qojnë në deficit kompanitë Amerikane. Shikuar më thellësishtë këtë aspekt SHBA-të ndoshta do të

bëjnë eksperimentet që të shohin se a mundet BOING të ekzistojnë vetëm, por në qoftë se ky eksperiment nuk ka sukses atëherë kësaj kompanie të aviacionit do t'iu dalë në ndihmë vetëm SHBA-ja, sepse airplanët janë pozicioni më i madh individual i eksportit Amerikan, përkatsisht një nga sektorët ku Amerika dominon në tregun global.

Kohëve të fundit Amerika po kalon në një deficit të mbrendshëm për shkak se në tregun e saj po veprojnë kompani shumë të fuqishme japoneze të cilat janë bërë të paarrtshme për vendet në të cilat veprojnë. Nëse e shikojmë ndikimin e SHBA-ve në këtë aspekt, mund të themi se në një menyrë vetëm SHBA-te e lejojnë këtë duke qenë treg i hapur. Pra SHBA-të shihen se kanë një ndikim të madh në ekonominë globale sepse nëse do të kishin marrë masa proteksioniste atëherë shumë ekonomi të vendeve tash të zhvilluara do të shkonin drejtë shkatërrimit. Amerika si superfuqi botërore po e shfrytëzon globalizimin për të udhëhequr apo dominuar botën në të gjitha aspektet e sigurisht edhe në aspektin ekonomik.

Kështu për pjesën më të madhe të elitës politike të Amerikës globalizimi nuk është vetëm një fakt për t'u observuar por një normë eksplicite. Ai afron një mekanizëm përshkrues dhe një përshkrim normativë. Pra Amerika ka luajtur rol shumë të rëndësishëm në qështjet e botës gjatë gjatëdhjetë vjetëve të kaluara, sa që tani për tani është pothuajse e pamundur si për evropianët ashtu edhe për aziatikët të paramendohet çfarëdo marrëveshje ndërkombëtare që në ndonjë mënyrë nuk përfshihet Amerika.

2.2.3 Ndikimi i Kinës në ekonominë Globale

Kina është bërë një nga superfuqitë ekonomike mallrat e saj mund të themi se gjenden në të gjithë globin. Kina me 1 miliardë e 300 milion banorë ka që me dije dhe me vullnet të shëndrrohet në një superfuqi botërore. Brutoprodhimi shoqëror po i afrohet billion dollarëve. Politika ekonomike Kinze si duket i njohur përparësitë ekonomisë sociale të tregut, ku njeriu dhe krijimtaria e tij janë në qendër të vëmendjes, ku shteti me zgjuarsi po e përcjellë zhvillimin ekonomik duke e drejtuar kapitalin e vetë me qëllim të shfrytëzimit për përparësi natyrore të kërkesave të tregut vetanë dhe duke i shfrytëzuar mangësitë e superfuqive botërore në aspektin ekonomik. Ekonomia kineze suksesshëm po e organizon prodhimtarinë, kurse sistemi bankarë gjithnjë e më shumë po riorganizohet në drejtim të stabilitetit duke u mbështetur në rezervat financiare të letrave më vlerë shtetërore amerikane.

Në këtë kontekst mund të themi se ky kapital po i mundëson kësaj ekonomie që të jetë në rrjedhat e tregut global të kapitalit, tregut dhe mallit. Kina këtë kapital të madh, përkatësisht këtë ndikim me produktete saj e ka arritur me një fuqi të madhe puntëtore të disiplinuar dhe shumë të përkushtuar në zhvillimin e vendit në aspektin ekonomik. Duart e vyera kineze dhe aftësia politike e shtetit e kanë sjellur prodhimin kinez në të gjitha pjesët e tregut global, duke i dhënë Kinës një pozitë shumë të volitshme në tregun global. Qasja kineze në tregun global me mallra e tyre, i ka bërë të mundshme asaj që të dridhë kapitalin e fjetur të Europës dhe të Amerikës. Nëse e analizojmë këtë çështje në kontekst të globalizimit atëherë mund të themi se në mënyrë paradoksale është përvetësimi i globalizimit më shumë, sesa rregullimi tij nga ana Kinës.

Pra Kina është ajo e cila mund ta dëmtojë dominimin ekonomik amerikan në tërë botën. Rendi i ri ekonomik botërorë nuk lejon hapësirë për dominim të fuqive perëndimore në ekonominë globale. Me fjalë të tjera prezenca e mallit dhe kapitalit Kinez, dhe ndikimi i tij në rregullin global e ka rezistuar mundësinë e dominimit dhe këtë për arsye se prodhimet kineze e kanë vërshtuar tregun global, dhe kjo po e bënë Kinën që të ketë shkallën më të lartë të zhvillimit ekonomik në botë.

